



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1147/4 prot

Datë 15.06.2022

V E N D I M

Nr. 560/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.06.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “*Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD*” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjellës Kanalizime Durrës.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Ankimues:

BOE “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK
Adresa: Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Sh.A Ujësjellës Kanalizime Durrës
Adresa: L.17, Rr. “Dalip Peza”

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4,*

i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë të Komisionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.03.2022, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Durrës.

II.2. Në datën 23.05.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi rezultatin e vlerësimit nga KVO të ofertave të paraqitura.

II.3. Në datën 30.05.2022 është publikuar **njoftimi i Fituesit** në Sistemin e Prokurimeve Elektronike si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 72, më datë 06.06.2022.

II.4. Në datën 30.05.2022 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK ka paraqitur ankesë me nr. 1147 protokollin dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2237, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit me nr. 1147/2 prot., datë 31.05.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 2721/3 prot., datë 06.06.2022, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 1147/3 prot., datë 09.06.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Inpress” SHPK & “Interlogistic” SHPK dhe me shkresën nr. 2721/3 prot., datë 06.06.2022, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, *GSHA pas shqyrtimit të ankesës së BOE si dhe referuar vlerësimit të KVO-së dhe DST-ve arsyeton:*

- 1. Në lidhje me kriteret e përgjithshme të kualifikimit marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet BOE Inpress dhe Interlogistic, nuk është e vlefshme pasi është nënshkruar nga Administratori E. H., në një kohë kur administratori i OE Interlogistic, E. H., autorizon sipas prokurës nr. 2257 datë 18.12.2020 Znj. L.L., si përfaqësuese të kompanisë, për firmosje të të gjithë dokumentacionit në procedurat e tenderit. GSHA arsyeton se fakti që Administratori Z. E.H., autorizon sipas prokurës nr. 2257 datë 18.12.2020 Znj. L.L., si përfaqësuese të kompanisë, për firmosje të të gjithë dokumentacionit në procedurat e tenderit nuk ja heq atij kompetencat e administratorit dhe të drejtën për të firmosur dokumenta. **Ankesa e operatorit ekonomik për këtë pikë qëndron.***
- 2. Në lidhje me kriteret e përgjithshme të kualifikimit pikën: Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet BOE Inpress dhe Interlogistic, është nënshkruar nga Adm.Edmond Hido dhe në nenin nr.3.3 të kësaj marrëveshjeje, është vendosur Autoriteti Kontaktor Posta Shqiptare. Pra kjo marrëveshje nuk është e vlefshme. GSHA vëren se marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet BOE Inpress dhe Interlogistic është specifikuar numri i referencës dhe objekti/titulli i kontratës dhe vlera e fondit limit dhe data e parashikuar e zhvillimit të procedurës prokuruese, të cilat përkojnë me objektin në fjalë. Për sa i përket citimit të bërë në nenin 3.3. arsyetojmë që bëhet fjalë për një gabim njerëzor i cili nuk cënon destinacionin e marrëveshjes. **Ankesa e operatorit ekonomik për këtë pikë qëndron.***
- 3. Në lidhje me pikën ku BOE Inpress SHPK nuk plotëson kriterin e përcaktuar në 1. Kapaciteti teknik pika 2.3.4 të DST/ pasi: nuk kanë paraqitur faturë apo dokument zhdoganimi për kamerat e sigurisë CCTV” GSHA vëren se më datë 22.04.2022 referuar ankesave në fazën e kritereve kualifikuese, në lidhje me këtë pikë, në sistemin e SPE është ngarkuar shtojcë me ndryshimet si më poshtë:*

ISHTE:

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë sistem kamerash dhe access kontroll. Kjo të vërtetohet me anë të një vetëdeklarimi nga Operatori Ekonomik.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta dhe të ruajtura për magazinim dhe prodhim, të siguruara me kamera sigurie. Për Plotësimin e këtij kriteri OE duhet të paraqesë faturat ose dokument zhdoganimi ,në të cilën shprehet se objekti është i mbikqyrur nga kamerat e sigurisë CCTV.

BËHET:

2.3.3 Operatori ekonomik për ambientet ku do të kryhet procesi i punës, duhet të disponojë sistem kamerash dhe akses kontroll. **Kjo të vërtetohet me ane të një vetëdeklarimi nga operatori ekonomik në të cilën shprehet se objekti është i mbikqyrur nga kamerat e sigurisë CCTV dhe se disponon access kontroll.**

2.3.4, Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente të sigurta e të ruajtura me sistem kamerash për magazinim dhe prodhim ku do të kryhet procesi i punës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë: Certifikatë pronësie dhe foto të ambientit ose kontratë qeraje të noterizuar dhe foto të ambientit të vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës.

Për sa më sipër operatori ekonomik nuk duhet të paraqiste faturë apo dokument zhdoganimi për kamerat e sigurisë CCTV. Ankesa e operatorit ekonomik për këtë pikë qëndron.

4. Për sa i përket vendimit të KVO të AK, për skualifikimin e BOE Inpress SHPK dhe Interlogistic SHPK me arsyetimin se: BOE nuk përmbush: Kapaciteti teknik pika 2.3.8 / pasi; OE "Inpress" ka paraqitur kartelë teknike vetëm për dy makineritë: makineri Fatura Nr.282/22 "Makineri Pajisje Dixhitale Ricoh Pro C901S" dhe makineri Fatura Nr.904/22 "Printer Ricoh 8110", dhe jo për tre të kërkuara në DST. Nga AK është kërkuar:

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 3 (tre) makineri dixhitale (2 për prodhim normal dhe 1 për rezervë në rast difekti). Të paktën 2 nga makineritë duhet të jenë me ngjyra. Disponimi i makinerikeve duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi ose cdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhet paraqitur kontrata qirasë e vlefshme bashkangjitur fatura e blerjes, ose çdo formë tjetër disponimi që njeh Kodi Civil i RSH.
- Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive nga të cilat duhet të rezultojnë se makineritë kanë një kapacitet prej jo më pak se 1041 fletë A4/orë të printuara nga të dyja anët.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë

GSHA arsyeton se, në SPE janë ngarkuar 2 fatura:

- Fatura Nr.282/22 "Makineri Pajisje Dixhitale Ricoh Pro C901S" (që janë 2 copë) dhe makineri.
- Fatura Nr.904/22 "Printer Ricoh 8110". Janë paraqitur 2 kartela teknike, 1 për "Makineri Pajisje Dixhitale Ricoh Pro C901S" e cila mendohet se i përfshin të dyja

*pajisjet, pasi në Faturën nr. 282/22 rezultojnë me të njëjtin përshkrim dhe një për "Printer Ricoh 8110". Për sa më sipër si dhe referuar kërkesave të AK, se vlerësimi i dokumentave pajisjeve dhe makinerive bëhet në fazën përpara publikimit të njoftimit fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, arsyetojmë se operatori ekonomik i përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.8. **Ankesa e operatorit ekonomik për këtë pikë qëndron.***

5. *Për sa i përket vendimit të KVO të AK, për skualifikimin e BOE Inpress SHPK dhe Interlogistic SHPK me arsyetimin se: kapaciteti teknik pika 2.3.8/pasi : Nuk ka kartelë teknike për makinerinë sipas faturës Nr. 228/22 "Pajisje Zarfimi Pitney Bowes DI 350"... GSHA vëren se në Kapacitetin teknik pika 2.3.8 kërkojnë dokumentat e sipërcituara në pikën 4. Për sa më sipër, në dokumentat standarde të tenderit dhe shtojcave me ndryshime, nga AK nuk është kërkuar dokumentacion për makinerinë "Pajisje Zarfimi Pitney Bowes DI 350"... **Ankesa e operatorit ekonomik për këtë pikë qëndron.***

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar shkresës nr. 2721/3 prot., datë 06.06.2022 të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka pranuar pjesërisht ankesën duke pranuar pretendimet lidhur me pretendimet për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë "Inpress" SHPK & "Interlogistic" SHPK.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: "*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera*".

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i cili parashikon shprehimisht se : "*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-23095-03-25-2022 me objekt “Shërbim i printimit dhe zarfimit të faturave për nevoja të UKD” me fond limit: 7,945,020.12 (shtatë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëzet presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 17.05.2022 nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujësjellës Kanalizime Durrës.
 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anëtar

Anila Malaj

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro

